



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 220/24

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 06.03.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


1. Lejohet subvencionimi deri në 100.00 € (njëqind euro) që Komuna do të paguajë nga fondi për transfere dhe subvencione, për secilin ndjekës të trajnimit, banorë rezident i Komunës së Vushtrrisë, të cilët e përfundojnë me sukses trajnimin në SPEEEX Edukation në Vushtri ose ndonjë kompani tjetër e licencuar e cila ushtron veprimtari të njëjtë në Vushtri apo kudo në Kosovë.
2. Pagesat nga pika 1 e këtij vendimi do të kryhen nga komuna për modulet e të mësuarit të gjuhës Gjermane apo Frënge.
3. Pagesa e mjeteve bëhet në llogari të secilit person që ka përfunduar me sukses trajnimin tre (3) mujorë dhe është pajisur me certifikatë nga SPEEEX Edukation në Vushtri apo kompani tjetër legale në Vushtri e cila ka kryer trajnime të fushave të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi, që mund të ofrojnë ofertë pune pas përfundimit të trajnimit. Pagesa bëhet në emër të personit që e ka kryer trajnimin, apo përfaqësuesit ligjorë, ose njërit prind nëse përfituesi i këtyre mjeteve është i moshës jo madhore.
4. Me rastin e aplikimit për këtë subvencion, duhet dorëzuar në zyrën pritëse të komunës: Kërkesa, adresuar për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, Certifikata valide nga kompania për kryerje të trajnimit, dëshmia për pagësë në llogari të kompanisë, si dhe Ekstrakti i lindjes me të cilën dëshmohet se është banor rezident i Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Për shkak të mbylljes së pagesave të vitit 2023 në muajin dhjetor 2023, aplikacionet e arritura pas datës së mbylljes së pagesave, të realizohen me buxhetin e vitit 2024. E njëjta gjë vlen edhe për aplikacionet e arritura pas mbylljes së pagesave në muajin dhjetor 2024 të cilat paguhen në fillim të vitit 2025.
7. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe duhet të zbatohet nga data 03 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2025.



Ferit Idrizi
Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 4 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nga buxheti i komunës – subvencione dhe transfere, lejohet subvencionimi i frekuentuesve të arsimit për të rritur të komunës së Vushtrrisë (sistemi për të rritur 3-6 muaj), të cilët i përfundojnë me sukses mësimet për aftësim profesional në Diakonie Training Center në Mitrovicë si dhe në qendra tjera të akredituara të arsimit profesional në Kosovë, deri në çmimet e poshtëshënuara:

Nr.	Lloji i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Çmimi për vitin akademik 2024
1	Instalues i ngrohjes qendrore	(3 muaj)	70€ për muaj 210 euro në total
2	Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit	(3 muaj)	70€ për muaj 210 euro në total
3	Instalues Elektrik	(3 muaj)	70€ për muaj 210 euro në total
4	Qeramikë	(5 javë)	100€ në total
5	Knauf, Fasadë dhe Ngjyrosje	(3 muaj)	70€ per muaj 210 euro në total
6	Make up – Grim	(2 muaj)	190€ për muaj 380€ në total
7	Rrobaqepësi	(5 muaj)	60€ për muaj 300 euro në total
8	Parukeri	(5 muaj)	90€ për 1 muaj 450 euro në total

2. Pagesa sipas pikës një (1) të këtij vendimi të bëhet për persona që janë banorë rezident të Komunës së Vushtrrisë të cilët me certifikatë e dëshmojnë kryerjen e aftësimin profesional nga data 03.01. deri më 31.12.2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit



Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës